



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2021

Njoftimi i kontratës për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të autoritetit kontraktor

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Ministria e Mbrojtjes
Adresa	Rruga e Dibrës, (ish Shkolla e Bashkuar), Tiranë
Tel/Fax	(04) 2226601/ (04) 2226602
Kutia Postare	2423
E-mail	prokurimeushtarake@mod.gov.al
Adresa e Internetit	www.mod.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e kufizuar” – prokurim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

3. Objekti i kontratës: “Blerje pajisje për administrimin e dokumentacionit (S1004)”.

4. Numri i referencës së procedurës: Urdhri i prokurimit nr. 46, datë 27.09.2021.

5. Fondi limit: 7,670,000 (shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në ditë **45**

ose

duke filluar nga lidhja e kontratës me përfundim brenda 45 ditëve.

7. Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:

15/11/2021 (dd/mm/vvvv) Ora:13:00

Kjo procedurë prokurimi do të zhvillohet në bazë të ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe përfshin dy faza kryesore:

Faza 1 – Parakualifikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve:

Faza e parë (para kualifikimi) ka të bëjë me përzgjedhjen e kandidatëve, përpara dërgimit të ftesës për ofertë nga AK-ja. Para kualifikimi i ofertuesve është një proces i ndryshëm nga procedura e vlerësimit të ofertave, e cila përqendrohet në çmimin dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Procesi i para kualifikimit do të bëhet duke u përqendruar në vlerësimin e përvojës dhe aftësinë e kandidatëve për të zbatuar në mënyrë të kënaqshme kontratën konkrete. Qëllimi kryesor i para kualifikimit është përzgjedhja e atyre kontraktorëve /furnitorëve, kualifikimet dhe përvoja e të cilëve minimizon rrezikun e mosekzekutimit, sipas projektit/kontratës së propozuar.

1.1 Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në Fazën e Parë, janë përkatësisht si më poshtë:

- Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin :
 - autorizimin e administratorit të shoqërisë për përfaqësimin në procedurën e prokurimit;
 - kopje të kartës së identitetit ose pasaportës për administratorin/personelin e autorizuar;
 - vërtetimin e lëshuar nga Gjykata për administratorin/personelin e autorizuar;
 - vërtetimin e lëshuar nga Prokuroria për administratorin/personelin e autorizuar;
 - vërtetimin e lëshuar nga zyra e Përmbarimit për administratorin/personelin e autorizuar;
 - dëshminë e penalitetit për administratorin/personelin e autorizuar;

ose

Kandidatët e interesuar duhet të jenë të pajisur me Certifikatën e Sigurimit Industrial (CSI), e cila duhet të jetë a) e vlefshme në momentin e prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së klasifikuar dhe b) në përputhje me objektin specifik të prokurimit të klasifikuar.

- Kopje të deklaratave të xhiros së ofertuesit për 3 (tre) vitet e fundit financiare, (2018-2019-2020). Xhiro mesatare e tre viteve të fundit, nuk duhet të jetë më e ulët se 40 % e vleres së fondit limit objekt prokurimi.
- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se kanë përvojë të suksesshme për funizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët ekonomike duhet të paraqesin :

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik operatori ekonomik si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqes vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Faza 2 - Ftesa për Ofertë dhe vlerësimi: Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët të cilët kanë plotësuar kërkesat për para-kualifikim duke i ftuar të dorëzojnë ofertat sipas përcaktimeve në DT dhe të specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën, fituese.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR